

Masat që merren nga 23 maji

Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Rrespektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri.

Shumica e rregullave janë hequr më 23 maj. Por çfarë duhet të bësh akoma?

Maskat për gojë

- Nëse je 12vjeç, ose ke moshë më të madhe, atëherë maska për gojë është e detyrueshme.
 - Tek mjeku apo tek farmacisti.
 - Në spital.
- Nëse je në një vend me shumë njerëz, atëherë është mira t'a mbash/vendosësh një maskë për gojë.

Udhëtime jashtë shtetit

- Nëse udhëton jashtë shtetit, atëherë janë disa kode me ngjyra :
 - Gri: rajon ose shtet për të cilin ka pak informacione. Është mira të mos udhëtosh për atje.
 - E kuqe e mbyllur/errët: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të madh për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
 - Portokalle ose e kuqe: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të mesëm për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për atje.
 - Jeshil/ e gjelbër: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të vogël për koronavirus. Por ti mund të udhëtosh për atje.
 - Shiko tek faqja e internetit <https://www.info-coronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>
- Shiko në diplomatie.belgium.be se cilat rregulla janë në shtetin ku ti do të shkosh!

Vjen nga një zonë me rrezik shumë të madh?

- Një listë të këtyre zonave e gjen në <https://info-coronavirus.be/nl/hoog-risicolanden/>
- Nëse ky është një shtet jashtë Bashkimit Evropian atëherë :
 - Është e detyrueshme të futesh për 10 ditë në karantinë. Kjo vlen për të gjithë.
 - Bëj test në ditën 1 dhe 7 pasi je kthyer në Belgjikë!
- Nëse ky është një shtet brenda Bashkimit Evropian ose Zonës Shengen dhe :
 - Nuk ke çertifikatë vaksinimi? Atëherë bëj test në ditën 1 pasi je kthyer në shtet!
 - Nëse testi yt është negativ, atëherë lejohet të dalësh nga karantina. Pastaj bëj edhe një herë test në ditën 7!

- Nëse një test është pozitiv, atëherë ti duhet detyrimisht të futesh 7 ditë në izolim.

Këta rregulla janë të rëndësishëm për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ata. Faleminderit që do të bësh këtë gjë. Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.